



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

**RAPORT GJYSMËVJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK
PËR PERIUdhËN JANAR – QERSHOR 2022**

1.Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2022, Ministria e Mbrojtjes (këtu e në vijim, MM) ka përmbushur në masën 100%, detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i Ligjit Nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për vitin 2022, janë konsultuar nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (këtu e në vijim RENjKP) dhe/ose aktiviteteve të tjera konsultative, akti i mëposhtëm:

1. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.13/2015 “Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH”.
 - Referenca tek Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2022: nr.10;
 - Referenca tek Plani Vjetor i Konsultimit për vitin 2021: nr.10;
 - Referenca tek Vlerësimi i Ndikimit Rregullator (VNR): 2021 – MM – Nr. 3
 - Referenca tek Plani Kombëtar për Integrimin Evropian: n/a

Takimet konsultative janë zhvilluar me aktorë e grupeve të interesit lidhur me projektligjin, përpos publikimit në platformën online të Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.

Në këtë kontekst, indeksi i frekuencës së organizimit të takimeve publike (IPM) është 100 % pasi akti i është nënshtruar takimeve publike. ($IPM = 1/1 * 100 = 100\%$).

Në takime kanë marrë pjesë aktorë joqeveritarë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (Shtabit të Përgjithshëm të FA, Komandave të Forcave, Komandës Mbështetëse, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes), të cilët përbëjnë dhe grupin kryesor të interesit në këtë projektligj, ku kërkohet përcjellja pranë grupit të punës i sugjerimeve dhe propozimeve konkrete mbi ndryshimet që duhej të pësojë ligji aktual, pasi të njihen me problematikat që ka sjellë ligji gjatë zbatimit.

Ministria e Mbrojtjes edhe për këtë periudhë raportimi janar-qershor 2022, ka vijuar të kryejë procesin e konsultimit publik për aktet objekt i ligjit të konsultimit publik, ashtu sikundër dhe në periudhat e mëparshme, duke respektuar standardet dhe parimet e procesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Akte të miratuara për periudhën 6 mujore të vitit 2022 janë 17 shtatëmbëdhjetë.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Është konsultuar 1 akt objekt i ligjit për konsultimin publik. Aktet e tjera sipas shkronjës “c”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi.

Ndërkohë janë në proces konsultimi 3 (tre) akte

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.13/2015 “Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH”, është konsultuar me raport VNR, i cili pas procesit të konsultimit u ndryshuar bazuar në rezultatet e procesit.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përfundimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Ministria e Mbrojtjes ka parashikuar në Program Analitik miratimin e 30 akteve, ku për 21 prej të cilave aplikohen përfundimet e parashikuara në shkronjën “c”, të nenit 4, të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Në PKIE për vitin 2022 janë parashikuar miratimi i 3 akteve, ndërsa 27 të tjera nuk lidhen me përafrimin me acqie-në, ndërsa asnjë prej tyre nuk lidhet me dokumentet strategjike sektorial.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

1 Projektligj

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

- Konsultimet publike janë një proces tashmë rutinë për Ministrinë e Mbrojtjes. Meqenëse periudha e pandemisë është në përfundim dhe rreziku nuk është i madh, do zhvillohen takime nga afër.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)



Nisur nga situata e pazakontë e shkaktuar nga pandemia Covid-19, metodat e konsultimit të aktit ishin 2, si më poshtë:

- Regjistri elektronik për njoftim dhe konsultim publik;
- Nëpërmjet sistemit e-Aktet, ku janë dërguar për mendim në ministritë e linjës.

100% e akteve të planifikuara për këtë periudhë u konsultuan nëpërmjet Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe sistemit të e-Akteve. Nisur nga situata e ndalimit të grumbullimeve të njerëzve në ambiente të mbyllura, takimet publike dhe fushatat me prezencë nuk janë realizuar dhe procesi i konsultimit është kryer vetëm nëpërmjet dy metodave të sipërpërmendura.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Publikimi në regjistrin elektronik të konsultimit publik ka qenë i frytshëm sepse ka mundësuar që të interesuarit të shohin aktet, por nuk ka gjeneruar komente.

Komentet janë mbledhur nga metoda e takimeve konsultative.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

- Vetëm në 1 (një) rast.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

- Konsultimet publike në RENJK kanë qenë të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

- Kohëzgjatja e konsultimit në regjistrin elektronik ka qenë 26 ditë.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

- Situata është përmirësuar krahasuar me vitin e kaluar. Çdo akt, i cili duhet t'i nënshtrohet konsultimit publik, është konsultuar.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MBROJTJES

- Nuk ka patur aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë.
- 2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)*

- Nuk ka patur
- 2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Në konsultimin publik të projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.59/2014 “Për karrierën ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhanë komente 6 strukturat shtetërore që ndikohen nga projektligji. Sipas raportit individual të konsultimit publik të publikuar në RENJK.

Në RENJK nuk ka patur komente nga publiku. Akti është konsultuar teknikisht dhe me ministrinë e linjës, ku janë gjeneruar dhe komente.

- 2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Strukturat shtetërore që ndikohen nga projektligji.

- i. Ministria e Mbrojtjes;
- ii. Shtabi i Përgjithshëm i FARSH;
- iii. Komanda e Forcës Tokësore;
- iv. Komanda e Forcës Ajrore;
- v. Komanda e Forcës Detare;
- vi. Komanda Mbështetëse;
- vii. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

2.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët për akte të caktuara.

Vlerësojmë se gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2022, një faktor që mund të ketë ndikuar në mungesën e reagimeve nga ana e publikut ka qenë dhe situata e krijuar nga pandemia e shkaktuar nga COVID-19.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

- 2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

14 komente janë mbledhur nga takimet konsultative.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

- 10 komente u pranuan, 4 komente u refuzuan

Grafik1: shkalla e pranimit të reagimeve të mbledhura



2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Krahasuar me vitet e kaluara, ku takimet publike ishin metoda që gjeneronte numrin më të madh të komenteve, kjo periudhë nuk ishte në një gjendje të kënaqshme, duke qenë se përfshirja e publikut nuk ishte në nivelin ndikues.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

- Raporti i VNR-së është përditësuar

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

1 raport pasi 1 akt i konsultuar është miratuar.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

- Nuk kemi lënë akt pa hedhur për konsultim publik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Në përfundim, bazuar në vlerësimin e cilësisë së performancës institucionale sipas metodologjisë Sigma, Ministria e Mbrojtjes renditet në kolonën e pestë (8 pikë), duke qenë se Projektligjet publikohen në sistemin e informacionit të qeverisë, është dhënë informacion i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit; janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre, në draftin e ri pasqyrohet një shkallë e mirë e reflektimit të reagimit të palëve të interesuara

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Në përfundim mund të themi që procesi i konsultimit publik, pavarësisht se është një praktikë që ndiqet prej kohësh tashmë, paraqet sfida të ndryshme, që lidhen herë më situatën në të cilën ndodhet vendi, herë me natyrën e aktit.

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithë- përfshirjen e publikut në këtë proces. Shihet një neglizhencë e qytetarëve, ekspertëve, bizneseve dhe grupeve të shoqërisë civile në pjesëmarrjen në proceset e konsultimit në regjistrin elektronik.

Situata e shkaktuar nga pandemia ka ndikuar në gjithë procesin e konsultimit, duke qenë se nuk janë realizuar takimet në prezencë, të cilat gjenerojnë dhe numrin më të madh të komenteve dhe përfshirjen e publikut. Mbetet për t'u identifikuar një zgjidhje alternative për adresimin e kësaj sfide dhe përmirësimin e procesit të konsultimit në tërësi.

Sfidë tjetër që paraqitet në këtë kuadër është dhe mungesa e ekspertizës në një fushë të caktuar. Në rastet e akteve shumë teknike, në fusha shumë specifike, mos-reagimi vjen si pasojë e vështirësisë së të kuptuarit të aktit. Në këtë drejtim, një zgjidhje do të ishte zhvillimi i ditëve informative me palët e interesit, në mënyrë që gjithsecili të kuptojë risitë apo ndryshimet që parashikon akti. Në këtë mënyrë rriten njohuritë e palëve të interesuara për aktet dhe nxitet kështu komunikimi dhe diskutimet mbi projektaktin. Bashkëpunimi brenda institucional dhe ndërinstytucional është gjithmonë një pikë kyçe e mbarëvajtjes së një procesi të konsultimit.